REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1089/20
Datë/Datum. 11.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Oper.Sistemi, Trans dhe Tregu, KOSTT SH.A*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: ***KOSTT 20 – 4505 -5-1-1***

Sa i përket tenderit për: *Furnizimi dhe instalimi i NS GIS, AIS, Transformatoreve Energjetik dhe LP, Lot 3: Ndertimi i nen-stacionit te ri – AIS 220 35 10 (20) kV Malisheva me linjen percjellese 220 kV*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

DOKO shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Zona Industriale, prane Kombinatit Siderugjik, Elbasan, Shqiperi
(Adresa)

Elbasan, Republika e Shqiperise — *3001*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

00 355 68 20 75 700
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Zt.Fatbardh Doko, Administrator
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@doko.al
(Adresa elektronike)

NUIS: J62903324K DOKO Sh.p.k. ELBASAN - ALBANIA

11 dhjetor 2020
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) — *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Me daten 21 / 08 / 2020, Autoriteti Kontraktues, ka bere shpalljen e Njoftimit te Kontrates kurse afati per dorezimin e tenderit ka qene me daten 06 / 10 / 2020.

Me daten 24 / 11 / 2020, KOSTT SH.A, ka bere shpalljen e njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues per njoftim per dhenie te kontrates, i publikuar në platformën elektronike e-Prokurimi.

Kriteri: oferta e pergjegjeshme me cmim me te ulte.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Eshte organizuar hapja publike e ofertave ne sistemin e E-prokurimit por nuk kemi marre pjese ne hapjen publike te ofertave.

Me daten, 06 / 10 / 2020, Autoriteti Kontraktues, ka dorezuar procesverbalin e hapjes publike te ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Kompania 'DOKO' shpk, me daten, 27 / 11 / 2020, ka parashtruar Kerkesen per Rishqyrtim duke ofruar argumente ligjore per shkelje te neneve 1, 2, 6, 7, 27, 28, 59, 65 – 71 dhe 72 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042 dhe nenit 39 te Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik per shkak se Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnje arsyetim ligjor ne te gjitha argumentet ligjore te prezentuara qarte ne Kerkesen per Ri-shqyrtim.

NUI: 812903324K DOKO Sh.p.k. ELBASAN - ALBANIA

Ne Kerkesen per Rishqyrtim, kemi potencuar se vendimi i Autoritetit Kontraktues per eliminim nga tenderi me arsyetim te pabazuar se Data Sheet (*fleta e te dhenave*) i Kabullit eshte pjeserisht jo i plote (*mungojne te dhenat e terminaleve per Kabllot e Tensionit te Mesem*) **nuk bazohet ligjerisht** ne Specifikacionet Teknike te Detajuara ne Gjuhen Angleze dhe **ne asnje dispozite tjeter ligjore te Dosjes se Tenderit dhe ne asnje dispozite tjeter ligjore te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves**.

Si rrjedhoje, ne Kerkesen per Rishqyrtim, kemi potencuar se Autoriteti Kontraktues gjate procesit te vleresimit te ofertave ka mundur pa asnje kufizim ligjore te kerkoje sqarim ligjor per dokumentet qe jane pjese e Ofertes se Kompanise 'DOKO' shpk lidhur me ceshtjen e Kabllove te Tensionit te Mesem por nje akt te tille te verifikimit dhe vertetimit te gjendjes faktike nuk eshte bere nga anetaret e komisionit per vleresimin e ofertave dhe as nga Departamenti i Prokurimit ne KOSTT SH.A.

Duke u nisur nga kjo, Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje te rende te nenit 59, 72 dhe 65 – 71 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042 ngase me veprime te tilla te pabazuara ligjore ka bere vleresim subjektiv, jo ligjore dhe jo profesional te Ofertes se Kompanise 'DOKO' shpk.

Ne argumentet ligjore qe do te prezentohen ne Ankesen drejtuar OSHP-se do te konstatohet se Oferta e Kompanise 'DOKO' shpk eshte Oferte e pergjegjeshme dhe Oferte performuese ne pajtim te plote me te gjitha kerkesat dhe kushtet teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Me daten 02 dhjetor 2020, Autoriteti Kontraktues, refuzon Kerkesen per Rishqyrtim dhe pergjigjet duke mos ofruar argumente ligjore me arsyetim ligjor ne te gjitha argumentet ligjore te Kompanise 'DOKO' shpk ne menyre konkrete dhe ligjore por vetem me nje vleresim te pabaze kinse konstatimet nuk qendrojne.

Refuzimi i Autoritetit Kontraktues pa ofruar argumente ligjore ne te gjitha pretendimet ankimore me arsyetim ligjor eshte ne kundershtim me nenin 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L - 042 dhe me nenin 8 te Rregullave per parashtrim te ankesave dhe flet qarte per subjektivizimin e larte te Autoritetit Kontraktues ne vleresimin e Kerkeses per Rishqyrtim.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kompania 'DOKO' sh.p.k, pas analizimit dhe studimit te dokumenteve relevante te Autoritetit Kontraktues dhe pas Vendimit te saj kunder Kerkeses per Ri-shqyrtim ne proceduren e prokurimit per: Furnizimin dhe instalimin e NS GIS, AIS, Transformatoreve Energjetik dhe LP, Lot 3: Ndertimi i nen-stacionit te ri – AIS 220 35 10 (20) kV Malisheva me linjen percjellese 220 kV, konsideron se Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje te dispozitave ligjore te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves me nr. 04 / L – 042.

Dispozitat e shkelura nga ***Autoriteti Kontraktues – KOSTT SH.A,*** jane mese vijon:

- *Eshte shkelur neni 59., i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 27 dhe 28 , i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 72, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 65 - 71, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 1, 2 6, dhe 7, i Ligjit te Prokurimit Publik*
- *Eshte shkelur neni 39, i Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik*

NUIS: J62903324K DOKO Sh.p.k. ELBASAN - ALBANIA

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania 'DOKO' sh.pk, pas analizimit te teresishem te dokumenteve relevante te Tenderit per: Furnizimi dhe instalimi i NS GIS, AIS, Transformatoreve Energjetik dhe LP, Lot 3: Ndertimi i nen-stacionit te ri – AIS 220 35 10 (20) kV Malisheva me linjen percjellese 220 kV, konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues – KOSTT SH.A, ka bere shkelje ligjore ne mos vleresimin e drejte, ligjor dhe objektiv te Ofertes sone qe eshte Oferte performuese dhe Oferte e pergjegjshme ne pajtim te plote me kerkesat, kushtet dhe kriteret e percaktuara ne Dosje te Tenderit.

Pikat e Ankeses per shkeljet e pretenduara te Autoritetit Kontraktues *jane te prezentuara si vijon:*

1. Autoriteti Kontraktues, me daten 24 / 11 / 2020, nepermjet portalit E-prokurimi te KRPP-se, publikon Njoftimin mbi Vendimin per Njoftim per Dhenie te Kontrates per prokurimin: Furnizimi dhe instalimi i NS GIS, AIS, Transformatoreve Energjetik dhe LP, Lot 3: Ndertimi i nen-stacionit te ri – AIS 220 35 10 (20) kV Malisheva me linjen percjellese 220 kV

2. Kompania 'DOKO' shpk, pas publikimit te Njoftimit mbi Vendim per Dhenie te Kontrates, me daten 27 / 11 / 2020, ka pergaditur dhe dorezuar Kerkesen per Ri-shqyrtim ne Autoritetin Kontraktues.

   Ne Kerkesen per Ri-shqyrtim, kemi listuar argumente te mjaftueshme ligjore qe Oferta e Kompanise 'DOKO' shpk eshte Oferte e pergjegjeshme dhe ne pajtim me kerkesat, kushtet dhe kerkesat e Autoritetit Kontraktues.

   Gjitheashtu, ne Kerkesen per Rishqyrtim, kemi potencuar se nuk ka asnje 'kerkese' e detajuar per Terminalet e Kabullit te Tensionit te Mesem **ngase kjo KERKESE nuk eshte 'specifikuar' ligjerisht ne menyre specifike dhe adekuate** as ne Kerkesat Teknike dhe as ne Specifikacionet Teknike te Detyrueshme ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen angleze te Dosjes se Tenderit ne menyre qe ky Data Sheet (*Fleta e te Dhenave*) per Kabllot te i permbaje 'parametrat' minimale qe do te kishte kerkuar Autoriteti Kontraktues ne vet Dosje te Tenderit.

   Prandaj, per fat te keq, Oferta e Kompanise 'DOKO' shpk refuzohet dhe shpallet e pa-pergjegjeshme dhe nuk vleresohet drejte dhe ligjshem nga KOSTT per nje 'kerkese' qe nuk eshte specifikuar 'qarte' ne Dosje te Tenderit dhe qe per te njejten Kerkese pa asnje pengese ose kufizim ligjor sipas nenit 28 te Dosjes se Tenderit dhe sipas nenit 72 ka mundur te kerkoje sqarime nga Kompania 'DOKO' shpk;

   Ne Kerkesen per Rishqyrtim, kemi prezentuar, si fakt kryesor, Data Sheet per Kabllot e Tensionit te Mesem me te gjitha parametrat e nevojshme teknike si dhe informacionet per prodhuesin e Kabllove.

   Autoriteti Kontraktues, pas marrjes se Data Sheet per Kabllot te kompletuar nepermjet Kerkeses per Rishqyrtim ka mundur te beje ekzaminim/verifikim tek Prodhuesi ose te marre sqarime shtese nga Kompania 'DOKO' shpk por nje veprim te tille nuk e kane ndermarre edhe pse kane obligim ligjor qe cdo Oferte te vleresojne, krahasojne dhe verifikojne ne aspektin teknik, ligjor dhe financiar sipas nenit 59 dhe 72 te Ligjit te Prokurimit Publik te Kosoves;

3. Autoriteti Kontraktues, me daten 02 / 12 / 2020, ka dorezuar Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim.

   Ne Vendimin per Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues, jep arsyetime te pabazuara dhe te paargumentuara me vetem nje 'konstatim te pabaze' qe sipas mendimit te Kompanise sone, i mohohet e drejta e fitimit te kontrates publike ne menyre te rregulte dhe ligjore dhe nuk jep asnje pergjigje ligjore ne te gjitha pikat tona pretendimore edhe pse kane

NUIS: J62903324K DOKO sh.p.k. ELBASAN - ALBANIA

detyrim ligjor sipas nenit 108 / A te Ligjit te Prokurimit me nr. 04 / L – 042 dhe sipas nenit 8 te Rregullave per parashtrim te ankesave;

4. Ne nderlidheshmeri, me piken 2 dhe 3 te Ankeses, Autoriteti Kontraktues, ka bere shkelje ligjore te nenit 27, 28 dhe nenit 69 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042 dhe nenit 39 te Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik per arsye se vleresimi i Ofertueseve **behet 'eksluzivisht' kundrejt KERKESAVE** qe jane te specifikuara ne Fleten e te Dhenave te Dosjes se Tenderit dhe ne specifikacionet teknike te detyrueshme ne gjuhen angleze dhe aftesite teknike dhe profesionale.

   Autoriteti Kontraktues, ne menyre profesionale, nuk i ka qartesuar drejte dhe ne menyre specifike kerkesat teknike per Kabllot e Tensionit te Mesem **dhe per mos qartesim te kerkeses per Kabllot e Tensionit te Mesem eshte Jo-ligjore dhe e padrejte qe te refuzohet Oferta e Kompanise 'DOKO' shpk** ngase ka pervoje shume vjecare ne ndertim te nen-stacioneve te linjave te energjise elektrike brenda dhe jashte shtetit me staf te kualifikuar teknik dhe ka aftesi teknike per implementim te kontrates publike ne afatin e parapare ligjor te realizimit te projektit.

5. Ne nderlidhshemeri, me piken 4 te Ankeses, Kompania 'DOKO' shpk, ri-potencon se Kabllot e Tensionit te Mesem jane pjese perberese e vet Projektit dhe e Specifikacionit Teknik te Detyrueshem ne gjuhen angleze dhe shqipe.

   Ne keto 2 specifikacione teknike, si pjese perberese, e Dosjes se Tenderit, potencohet rendesia e kabllove ne pergjithesi per ndertimin e nen-stacionit ne Malisheve dhe si produkt mjaft i rendesishem ne realizim te projektit, **Autoriteti Kontraktues, ka pasur obligim ligjor sipas nenit 28 te Dosjes se Tenderit dhe sipas nenit 72 te kerkoje 'sqarim ligjor' nga Kompania 'DOKO' shpk per 'parametrat' teknike per Kabllot e Tensionit te Mesem dhe cdo sqarim i ofruar do te permbante te gjitha parametrat e nevojshme teknike qe e siguron Autoritetin Kontraktues per cilesine dhe standardin e larte te Kabllave te Tensionit te Mesem** qe do te perdoren per realizim te projektit te nen-stacionit ne Komunen e Malisheves.

   Sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042, Autoriteti Kontraktues, gjate procesit te vleresimit te ofertave ka obligim ligjor qe te vleresoje, krahasoje dhe ekzaminoje Oferten e Kompanise 'DOKO' shpk ne cdo aspekt teknik, ligjor dhe financiar.

   Ne rastin konkret, anetaret e komisionit per vleresimin e ofertave, nuk kane bere 'ekzaminimi' te Ofertes sone kundrejt specifikacionit teknik te detyrueshem, Aneks 1 te Dosjes se Tenderit sepse 'verifikimi' ka qene i domosdoshem per te ardhur ne konstatim ligjor qe Oferta e Kompanise 'DOKO' shpk eshte Oferte e pergjegjshme dhe ne pajtueshmeri te plote me kerkesat teknike te potencuara ne Dosje te Tenderit.

   Me 'ekzaminim' nenkuptojme 'verifikim' te gjendjes faktike dhe si rrjedhoje procesi i vleresimit te ofertes sone nga Autoriteti Kontraktues eshte Jo-ligjor, subjektiv dhe jo profesional.

   Si rezultat i saj, edhe njehere ri-potencojme se Oferta e Kompanise 'DOKO' shpk eshte e Oferte e pergjegjeshme, performuese dhe produktet e ofruara me Oferte jane plotesisht funksionale, ashtu sic kerkohet me nenin 28 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe ashtu sic kerkohet me Specifikacionet Teknike te Detryueshme, Aneks 1 te Dosjes se Tenderit dhe nuk do te paraqiste asnje problem gjate implementimit te kontrates publike.

6. Autoriteti Kontraktues, ka shkelur edhe nenin 1, 2, 6 dhe 7 te Ligjit te Prokurimit Publik, me nr. 04 / L – 042 ngase po diskriminohet rende Kompania 'DOKO' shpk ne mos vleresimin e drejte dhe ligjore te ofertes sone te pergjegjeshme nga ana e komisionit vleresues te Autoritetit Kontraktues;

7. Kompania 'DOKO' shpk garanton per cilesine e produktit qe ri-konfirmon qe produkti i ofruar ne Oferten tone eshte ne pajtim te plote me specifkacioneve teknike te detyueshme te dosjes se tenderit (*pjese e specifikacionit teknik te detyrueshem*) dhe nuk ka asnje ndikim ne performancen dhe funksionalitetin e produktit te kerkuar nga KOSTT SH.A.

   Gjitheashtu, Kompania 'DOKO' shpk ka mundur te percjelle dhe te provoje mese mire

DOKO Sh.p.k. BELBASAN ALBANIA

dhenat teknike te kabllove te tensionit te mesem ekzistuese para Njoftimit te Kontrates ne perputhje me te gjitha standardet nderkombetare;

8. Kompania 'DOKO' shpk, do te paraqese, faktet konkrete, si pjese te argumentimit ligjor per te i mundesuar OSHP-se shqyrtimin e drejte dhe ligjor te argumenteve te prezentuara ne Ankese duke filluar me dorezimin e Data Sheet (*Fleta e te Dhenave*) per parametrat teknike qe permban Kablli i Tensionit te Mesem dhe ekstraktet e neneve te shkelura nga Autoriteti Kontraktues.

   Perfaqesuesit e Kompanise 'DOKO' shpk jane ne dispozicion per te ofruar sqarime profesionale teknike si per Ekspertin Teknik te OSHP-se por edhe per anetaret e OSHP-se gjate shqyrtimit te argumenteve tona ligjore me spjegime konkrete ligjore dhe teknike ne menyre qe te bindet Paneli Shqyrtues ne shkeljet ligjore te Autoritetit Kontraktues per refuzim te Ofertes sone qe eshte Oferte performuese dhe Oferte e pergjegjeshme ne pajtueshmeri te plote me kerkesat dhe kushtet teknike te potencuara ne Dosjen e Tenderit; dhe

9. Autoriteti Kontraktues, pas deponimit te kerkeses per qasje publike, ka ofruar qasje publike duke marre kopjen e Raportit te Vleresimit te Ofertave.

   Ne faqen 7 te Raportit te Vleresimit te Ofertave ceket se ne Oferten e Kompanise 'DOKO' shpk se ... citat .... '***vleresimi i Ofertes teknike te O.E lidhur me pajtueshmerine me kerkesat teknike te kerkuara ne dokumentin e specifikimit teknik*** .... mbyllje citati, jepet vetem nje pershkrim i pergjithshem dhe *Jo specifik dhe Jo ligjor gje qe eshte ne kundershtim me nenin 59 te Ligjit te Prokurimit Publik* sepse e tere Oferta jone teknike eshte ne pajtueshmeri te plote me 'kerkesat teknike te specifikuara ne Fleten e te Dhenave te Tenderit si dhe ne specifikacionet teknike te detyrueshme ne gjuhen angleze dhe ne gjuhen shqipe, Aneks 1 i Dosjes se Tenderit.

   Ne anen tjeter, ne faqen 12 te Raportit te Vleresimit te Ofertave qe nderlidhet me arsyet e pergjithshme te cekura ne faqen 7 te po te njejtit Raport ceket se mungon Datasheet per kabell eshte pjeserisht e pa plotesuar (*mungon pjesa per MV power cable terminations*) dhe qe Kompania 'DOKO' ka ofruar 3 teknologji per mbrotje, kontroll dhe SCADA.

   Autoriteti Kontraktues, sic kemi potencuar ne argumentet ligjore te potencuara ne pikat 1 deri 8 te Ankeses, ka bere shkelje ligjore te nenit 38 te Dosjes se Tenderit, nenit 59 dhe nenit 72 te Ligjit te Prokurimit Publik, nr. 04 / L – 042 dhe nenit 39 te Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik sepse nuk ka kerkuar 'sqarim ligjor' nga Kompania 'DOKO' shpk ngase **'Kabllot' e tensionit te mesem jane pjese e pandashme te specifikacionit teknik dhe pjese e Ofertes teknike** te dorezuar ne KOSTT SH.A.

   Kompania 'DOKO' shpk do te ofronte informatat dhe sqarimet e nevojshme per parametrat teknik te Kabllove te tensionit te mesem dhe pas sqarimeve te ofruara, Autoriteti Kontraktues, do te merrte vendim per te shpallur oferten tone si oferte e pergjegjshme dhe te konsiderohet potencialisht oferte per fitim te kontrates publike pasi ne teresi Oferta eshte ne pajtim me kerkesat dhe kushtet e dosjes se tenderit.

   Ne fund, **ri-potencojme argumentin ligjor se eshte Jo ligjore dhe e kunderligjshme** qe Autoriteti Kontraktues ne baze te raportit te vleresimit te ofertave dhe ne Letren per Tenderuesin e Eliminuar **pa ofruar 'arsyetimin ligjor' te bazuar ne ndonjeren nga dispozitat ligjore te Ligjin e Prokurimit Publik, nr. 04 / L – 042, Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik dhe ne asnje dispozite ligjore ne Dosje te Tenderit.**

   Prandaj, Kompania 'DOKO' shpk, e konsideron si Raportin e Vleresimit te Ofertave dhe Vendimin per eliminim nga aktivitetit i prokurimit per Lot 3, si vendim subjektiv dhe jo ligjor, i marr nga Autoriteti Kontraktues.

Shenim per argumentet ligjore te potencuara ne Ankese dhe faktet e bashkengjitura:

Ne pajtim me Rregulloren per Trajtimin e Ankesave dhe sic parashihet edhe me nenin 108/A te Ligjit te Prokurimit Publik pretendimet ankimore jane te njejta ku si parashtrues i Ankeses kemi ofruar arsyetimet tona ligjore dhe mos pajtimet ne arsyetimet e ofruara ne Vendimin per Refuzim te Kerkeses per Risqyrtim kundrejt argumenteve ligjore te potencuara ne Kerkesen per Rishqyrtim.

NIPT: J62903324K DOKO Sh.p.k. ELBASAN - ALBANIA

Ne parashtrim te Ankeses ne OSHP bejme edhe deponimin e provave relevante materiale me numer rendor per te i ofruar argumente te mjaftueshme ligjore si eksperteve por edhe anetareve te panelit shqyrtues te OSHP-se per te konstatuar drejte dhe ligjshem gjendjen faktike per lenden e kontestuar.

Perfaqesuesit ligjor te Kompanise si parashtrues te Ankeses ne OSHP jane ne dispozicion qe sipas Rregullores se Punes se OSHP-se por edhe ne baze te nenit 108 / A te Ligjit te Prokurimit Publik te ofroje sqarime ligjore lidhur me permbajten e argumenteve tona dhe provave te potencuara ne Ankese para Ekspertit dhe Panelit Shqyrtues poqese kerkohen sqarime lidhur me permbatjen e Ankeses.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania 'DOKO' shpk, me plotesimin e te gjitha kerkesave/kushteve te tenderit ka interes te caktuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankeses dhe ka qene nje nga Ofertuesit potencial per fitimin e kontrates publike ngase ka plotesuar te gjitha kerkesat teknike dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues dhe ka pasur oferte te pergjegjeshme dhe oferte performuese.

Prandaj, mos vleresimi i drejte dhe ligjor, ashtu sic kerkohet sipas nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik dhe mos fitimi potencial i nje kontrate publike ne menyre te rregullte ndikon ne shpenzime ligjore, humbje te fitimit real nga mos realizimi i projektit, si dhe reputacioni i Kompanise sone ne tregun konkurrues te Kosoves.

PROPOZIM

Duke u nisur nga prezentimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Kompania 'DOKO' shpk kerkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne menyre ligjore duke marre **Vendim per te kthyer lenden e kontestuar ne RI-VLERESIM te OFERTAVE,** ne menyre qe Autoriteti Kontraktues – KOSTT SH.A, te beje vleresim te serishem te ofertave me anetar te rinj te komsionit vleresues dhe te shpall fitues Kompanine 'DOKO' shpk, qe ka plotesuar te gjitha kushtet, kerkesat dhe kriteret e Autoritetit Kontraktues te potencuara ne Dosje te Tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

s

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

NUIS: J62903324K
DOKO
Sh.p.k.
ELBASAN - ALBANIA

Vendim

Operatori Ekonomik "DOKO" SH.P.K., Elbasan, pas publikimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues për dhënie(B58) dhe brenda afatit te parashikuar me LPP, me datë 27.11.2020 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, për Aktivitetin e Prokurimit:

"Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP" ,

LOT 3 Ndërtimi I Nënstacionet te Ri - AIS 220/35/10(20)kV Malisheva me linjën përcjellëse 220kV ;

Nr. i prokurimit **KOSTT-20-4505-5-1-1**

Nr. i brendshëm **KOSTT 023/140/155/156/157/140/1-20-49-511.**

Ne bazë të Nenit 115 të Ligjit të Prokurimit Publik në Kosovë, dhe Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, **Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit refuzon kërkesën për rishqyrtim për arsye se asnjë nga konstatimet e kërkesës nuk qëndrojnë.**

KËSHILLË JURIDIKE:

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë OSHP-së, në afat prej 10 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi.

Me respekt

Abdulsatar Ibrahimi

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

KOSTT sh.a.

Prishtinë, me 02.12.2020

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **KOSTT-20-4505-5-1-1**

Sa i përket tenderit për "**Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS, AIS, Transformatorëve Energjetik dhe LP" LOT 3, Ndërtimi I Nënstacionet te Ri - AIS 220 35 10(20)kV Malisheva me linjën përcjellëse 220kV**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj) ***DOKO sh.p.k***

(Adresa) ***Zona Industriale, Prane Kombinatit Siderugjik, Elbasan, Shqiperi***

(Vendi) **Elbasan,Shqiperi** *(Kodi postar)* **3001**

(Numri Telefonit) **+355682075700** *(Numri i Faks-it)* **+35558326066**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj) **Fatbardh DOKO**

(Adresa elektronike) *info@doko.al*

(Data e parashtrimit të kërkesës)

Dt 27.11.2020

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K DOKO ELBASAN - ALBANIA

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Refuzimi i ofertes se DOKO Sh.p.k. nga ana e Autoritetit Kontraktor eshte në kundërshtim me:

- Nenin 27, Nenin 28, Nenin 69, pika 6, 7 dhe nenin 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 "Per Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës", i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
- Piken 39 te "Rregullave dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik"
- Pika 28 e Dosjes se Tenderit publikuar nga Autoriteti Kontraktor.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar Zotërinj,

Shoqëria tregtare "DOKO" shpk, është një shoqëri e mirënjohur në tregun vëndas dhe nderkombetar me nje eksperience te gjate, kualifikime dhe vleresime ne nivel nderkombetar per aktivitetin e saj ne fushen e projektim, furnizim, ndertimit, testimit per linjat elektrike te tensionit te ulet, te mesem dhe te larte, projektim, furnizim, ndertimit, testimit per nenstacionet elektrike te tensionit te ulet, te mesem dhe te larte, hidrocentrale dhe cdo lloj impianti qe sherben per prodhimin e energjise elektrike, etj.

Më datë 21.08.2020 eshtë shpallur nga Autoriteti Kontraktor Oper. Sistemi,Trans.dhe Tregu- KOSTT SH.A., Procedura e Hapur Pune "Furnizimi dhe Instalimi i NS GIS,AIS,Transformatorëve Energjetik dhe LP".

Ne date 06.10.2020_,DOKO Sh.p.k. ka dorezuar nepermjet platformes online **e-prokurimi.rks-gov.net** dosjen e tenderit sipas kerkesave te Prokurimit nr. KOSTT-20-4505-5-1-1.

SH.P.K. DOKO ELBASAN - ALBANIA

Neni 69
Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Në procedurat që shpijnë në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet realizimi i projekteve të punëve ose realizimi i aktiviteteve ndërtimore, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre teknike dhe profesionale për kryerjen e projekteve të tilla ose realizimin e aktiviteteve të tilla; në veçanti, autoriteti kontraktues mund të kërkojë të dhëna përkitazi me:
raportin për mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit të punëve ose përmbushjen e aktiviteteve ndërtimore

Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës ose në ftesën për tenderim do të specifikojë se cilat referenca (dokumentacione) të saktësuara në këtë nen, i nevojiten.

Pra, nga sa me siper rezulton se Autoriteti Kontraktor ka detyrimin te specifikoje me detaje kerkesat teknike qe te jene sa me te qarta per Operatoret Ekonomike.

3. Bazuar ne Nenin 72 të Ligjit Nr. 04/L-042 "Per Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës", i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe piken 39 te "Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik" parashikohet sa me poshte:

Neni 72
Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji."

Rregullat dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik

39. Sqarimi i Tenderëve

39.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, *AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformes elektronike.*

39.3 Megjithatë, <u>lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender.</u> Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate.

39.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit te informacionit shtese në kushte të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë dhe do të kërkojë informacion nga operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave te përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit.

SH.P.K. DOKO ALBASAN ALBANIA

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
2. *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
3. *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
4. *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

Bashkengjitur ketij formulari do te gjeni:

1. Njoftim per Kontrate I dates 20.08.2020, publikuar me dt 21.08.2020 ne faqen e prokurimit eketronik.
2. Procesverbali i Hapjes se Tenderit, date 06.10.2020.
3. Njoftimi i Vendimit te Autoritetit Kontraktor per rezultatet e aktivitetit te prokurimit date 24.11.2020.
4. Letra standarte per tenderuesin e eleminuar, formulari B42.
5. Dosja e Tenderit, Kerkesat mbi mundesite teknike dhe profesionale.
6. Te dhenat teknike te terminaleve per kabllot e tensionit te mesem

SH.P.K. BOKO ELBASAN - ALBANIA